

Bashkia: SHIJAK

Kryetar: ARDIAN KOKOMANI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të ndërhyet në rrjetin e energjisë elektrike në territorin e bashkisë
2. Do të ndërhyet në furnizimin me ujë dhe rritjen e kapacitetit të prodhimit nëpërmjet të cilit synohet ndërtimi i një rrjeti të përshtatshëm shpërndarjeje në zonat informate
3. Do të hartohet një plan i ri urbanistik për bashkinë ku do të harmonizohen zhvillimi i zonave rurale me qytetin. Në këtë plan do të tregohet kujdes në planifikimin e zhvillimit integral të zonës dhe do të jetë i përfunduar brenda mandatit
4. Do të ndërhyet në infrastrukturën rrugore, në rrugët primare, si dhe rrugët dytësore; Këto rrugë do të kenë ndriçim, korsin lëvizës të biçikletave dhe do jenë të pajisura me sinjalistika rrugore të standardeve europiane
5. Do të kryhet ndërtimi i unazës së vogël të qytetit
6. Do të kryhet rikthimi i hapësirave publike në territorin e bashkisë
7. Do të kryhet përmirësimi dhe furnizimi me Ujë në Fllakë
8. Do të kryhet rehabilitimi i qendrës së qytetit Shijak
9. Do të ndërtohet një qendër shëndetësore në Maminas
10. Do të kryhet përmirësimi dhe ndërtimi i rrjetit të ri të Ujësjellësit në Maminas, Bilalas, Rubjek dhe Vlashaj
11. Do të investohet për ujin e pijshëm në Vlashaj dhe Karreç
12. Do të kryhet kanalizimi i ujërave të zeza në Sallmone
13. Do të kryhet asfaltimi i rrugëve në Xhafzotaj

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të ndërtohet një Qendër Rinore
2. Do të kryhen Këshillime Karriere dhe Këshillim për Punësimin
3. Do të ndërtohet Biblioteka e Qytetit
4. Do të kryhet ngritja e një Fondi për Nxënësit e Ekselencës
5. Do të rikonstruktohet Kopshti Nr 1
6. Do të rikonstruktohet shkolla 9-vjeçare “ Lidhja e Prizrenit”
7. Do të rikonstruktohet Kopshti Nr 2
8. Do të rikonstruktohet gjimnazi “16 Shtatori”
9. Do të kryhet rikonstruktion i shkollës 9-vjeçare “Muharrem Dollaku”

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Pretime:

Fusha: BUJQËSI

Pretime:

1. Do të kryhet restaurimi i stacionit të pompimit dhe i depos së Shilores, zëvendësimi i linjës kryesore, dhe pompave që furnizojnë fshatrat Gjepalaj, Koxhas, Shahinaj dhe Guzaj
2. Do të mundësohen subvencione nga AZHBR për produktet bio
3. Do të lobohet për tregtimin e produkteve, jo vetëm në tregun vendas por edhe në atë të huaj, kryesisht në tregun e evropian
4. Do të mbështetet rritja e kapacitetit të prodhimit
5. Do të ngrihet një drejtori që do të luajë rolin e koordinimit dhe nxitjes së lobimit ndërmjet shoqatave të agrobiznesit dhe fermerëve. Misioni i kësaj drejtorie do të jetë thithja e fondeve nga qeveria, Ministria e Bujqësisë si dhe nga agjenci dhe donatorë të ndryshëm, vendas apo edhe të huaj
6. Do të kryhet rikualifikim i kanaleve kulluese dhe vaditëse në territorin e bashkisë

Fusha: TRANSPARENCA

Pretime:

1. Do të mundësohet krijimi dhe nxitja e një ambienti të përshtatshëm, përmes të cilit do të kanalizohet përfshirja e qytetarëve, e grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në vendimmarrjet politike

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Pretime:

1. Do të kushtohet vëmendje dhe kujdes i veçantë për moshën e tretë dhe veteranët e luftës. Do të ngrihet një qendër ditore për moshën e tretë dhe do të organizohen aktivitete të ndryshme kulturore në territorin e bashkisë
2. Do të kryhet hapja e një qendre sociale për fëmijë e të moshuar në territorin e bashkisë

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Pretime: